



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 08 maj 2020
Nr. Ref.:RK 1559/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI58/18

Parashtrues

“IIC Assistance”

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, ARJ. UZVP nr. 69/ 2017, të 25 janarit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga “IIC Assistance” me seli në Prishtinë, i cili përfaqësohet nga përfaqësuesit e autorizuar Besnik Z. Nikqi dhe Visar Morina, përfaqësuesit e Zyrës së Avokatisë “ICS Assistance” nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ. UZVP nr. 69/2017] të 25 janarit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 prill 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 18 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 25 prill 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori Vendimin për zëvendësimin e gjyqtarit raportues Almiro Rodrigues, dhe në vend të tij caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese.
12. Më 11 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
13. Më 29 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës nxori Vendimin për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
14. Më 15 prill 2020, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 25 korrik 2002, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, si paraardhës i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: BQK) nxori Vendimin nr. 009, me të cilin parashtruesi i kërkesës (IIC Assistance) është licencuar si zyrë për trajtimin e dëmeve.
16. Më 18 korrik 2012, Bordi Ekzekutiv i BQK-së nxori Vendimin [nr. 49-30/2012], me të cilin e pezulloi licencën e parashtruesit të kërkesës (IIC Assistance) për arsye se *“për vitet e ekzaminuara nuk ka audituar pasqyrat financiare vjetore, siç kërkohet me nenin 49.1 të Rregullores Nr. 2001/25 mbi Licencimin, nuk ka instaluar sistem adekuat të kontrolleve të brendshme si dhe ka trajtuar lëndë për të cilat ekzaminerët e BQK-së kanë konstatuar se kanë përmbytje të falsifikuar dhe të inskenuar”*. Me këtë Vendim, Bordi Ekzekutiv i BQK-së e detyroi parashtruesin e kërkesës që të ndërpresë çdo angazhim që ka të bëjë me aktivitetin e sigurimeve.
17. Më 23 prill 2013, BQK zbatoi një ekzaminim të fokusuar të zyrës së parashtruesit të kërkesës, pasi *“BQK –ja ka pranuar informacione nga institucionet financiare se “IIC Assistance” është duke vepruar si trajtues i dëmeve me licence të pezulluar”*. Gjatë ekzaminimit zyrtarëve të BQK-se nga Menaxhmenti i “IIC Assistance” (i) ju janë prezantuar vendimi për pezullimin e licencës si dhe njoftimi i bashkëpunëtorëve të “IIC Assistance” lidhur me Vendimin e BQK-se nr.49-30/2012 për pezullim të licencës; (ii) zyrtarët e BQK-se janë njoftuar nga Menaxhmenti i “IIC Assistance” se tani kjo zyrë vepron me emër tjetër si “ICS Assistance”; (iii) se “ICS Assistance” ka strukturë tjetër organizative, e po ashtu merret me veprimtari tjetër; si dhe se (iv) “ICS Assistance” është e licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
18. Ekzaminerët e Departamentit për Licencim dhe Rregullim të BQK-së ekzaminuan *““ICS Assistance” dhe nga vlerësimi i dokumentacionit të pranuar nga Byroja Kosovare e Sigurimit është konstatuar se “ICS Assistance ka ushtruar aktivitet të vlerësimit të dëmeve pa u licencuar nga BQK”*. Ekzaminerët e Departamentit për Licencim dhe Rregullim të BQK-së i rekomanduan Bordit Ekzekutiv të BQK-së që parashtruesit të kërkesës, për shkak të shkeljeve të konstatuara, t’i revokohet licenca për trajtimin e dëmeve.

19. Më 30 prill 2013, Bordi Ekzekutiv i BQK-së me Vendimin [nr. 26-08/2013] e revokoi licencën e parashtruesit të kërkesës për trajtimin e dëmeve me arsyetim se *“ICS Assistance”, që në fakt janë persona të afërt dhe që kanë punuar edhe për “IIC Assistance”, i ka prezantuar BQK-së fakte të rrejtshme lidhur me aktivitetin të cilin janë duke e ushtruar (sipas tyre, këshilla juridike, regrese, etj.)*. *“IIC Assistance” dhe “ICS Assistance” menaxhohen nga persona të së njëjtës familje dhe duke qenë se të njëjtit kanë prezantuar fakte të rrejtshme në BQK, këta persona sipas Manualit për Licencim që e përdor BQK-ja nuk konsiderohen më tutje “të përshtatshëm dhe të duhur” (Fit and Proper), siç përcaktohet në nenin 52 të Rregullores nr. 2001/25”*.
20. Më 6 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kundër BQK-së, me të cilën kërkoi anulimin e Vendimit [nr. 26-08/2013] të 30 prillit 2013, të BQK-së, duke pretenduar se BQK *“nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, çfarë është pasojë e drejtpërdrejtë e konkluzioneve të gabuara dhe të paqëndrueshme që kanë rezultuar me marrjen e një vendimi të kundërligjshëm”*.
21. Më 19 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit [A. nr. 767/ 13] e refuzoi, si të pabazuar, padinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetim se *“vendimi i të paditurës i goditur me padi, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, sepse i njëjti është marrë pas vërtetimit të të gjitha fakteve relevante dhe është bazuar në dispozitat ligjore në fuqi”*.
22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [A. nr. 767/13] të 19 janarit 2016, për shkak të *“shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës administrative-kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*. Me këtë ankesë, parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata e Apelit që të anulohen Aktgjykimi [A. nr. 767/13] i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Vendimi [nr. 26-08/2013] i BQK-së.
23. Më 26 prill 2016, Gjykata e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative nxori Aktgjykimin [AA. nr. 757/2016], me të cilin e miratoi, si të bazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e prishi Aktgjykimin [A. nr. 767/2013, e datës 19.01.2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe e ktheu çështjen në të njëjtën gjykatë në rigjykim dhe rivendosje. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit e obligoi Gjykatën Themelore: *“që çështja kontestuese të shqyrtohet në tërësi dhe të vërtetohen në mënyrë të sigurt faktet relevante që janë me ndikim për zgjidhjen e kontestit, dhe në mënyrë të përcaktuar dhe të plotë ti theksoi faktet kontestuese dhe nga cilat shkaqe i merr si të provuara ose jo të provuara, duke theksuar qartë shkaqet për faktet vendimtare në mënyrë të kuptueshme të cilat duhet edhe arsyetuar. Pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të bie aktgjykim të drejt dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative”*.

24. Më 14 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në procedurën e serishme, përmes Aktgjykimit [A. nr. 657/16], e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në pjesën e arsyetimit në lidhje me rekomandimin e Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore *inter alia* thekson:

“vërtetohet edhe pretendimi si në arsyetimin e vendimit kontestues se përfaqësuesit e paditëses, me rastin e ekzaminimit të datës 28.03.2013, të paditurës i kanë paraqitur fakte që konsistojnë të rrejshme, duke deklaruar se ICS Assistance është zyre për këshilla juridike, regrese dhe se aktiviteti i tyre nuk është trajtimi i dëmeve, përderisa komunikimet e sipërcituara vërtetojnë se të njëjtit kanë ushtruar aktivitetin si trajtues i dëmeve”.

25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të *“shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës administrative/kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*. Me këtë ankesë kërkoi që të anulohet Aktgjykimi [A. nr. 657/16] i 14 dhjetorit 2016 i Gjykatës Themelore në Prishtinë.
26. Më 5 tetor 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [AA. nr. 81/2017], me të cilin e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë [A. nr. 657/2016], të 14 dhjetorit 2016.
27. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata e Apelit thekson se në bazë të:

“komunikimeve elektronike të datës 28.01.2013, 29.01.2013 dhe 13.02.2013, në mes të përfaqësuesit të ICS Assistance dhe BKS me të cilat vërtetohet se i njëjti është referuar si trajtues i licencuar i dëmeve, kështu që veprimi i tillë përbën shkelje të nenit 9.1 të Rregullores nr. 2001/25 që përcakton se “Askush nuk mund të angazhohet në biznesin e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit në Kosovë, nëse nuk është licencuar nga BQK-ja dhe nenit 4.1 të Rregullës 5 a) për licencimin e rregulluesve/mbikëqyrësve të dëmeve të sigurimeve të datës 28.03.2002, sipas të cilit “Asnjë person nuk do të angazhohet në veprimtarin e parashikuar me këtë rregull, apo të pretendojë të veprojë si i licencuar, përveç nëse është i licencuar në bazë të kësaj rregulle”. Prandaj, me të drejtë është konstatuar se veprimi i tillë përbën bazë për anulimin e licencës në pajtim me paragrafin (o) të nenit 15.1 të Rregullores nr. 2001/25. Ndërsa, në vështrim të nenit 52.3 të Rregullores këta persona sipas manualit për licencim që përdor BQK-ja nuk konsiderohen më tutje “Të përshtatshëm dhe të duhur”. Prandaj meqenëse paditësi nuk ka prezantuar në gjykatë asnjë provë që vërteton të kundërtën, organi i paditur drejt ka zbatuar dispozita e procedurës administrative dhe ligjit material kur i ka revokuar licencën paditësit, se nga provat e administruara u vërtetua se paditësi nuk kishte vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi. [...] Po ashtu, kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit në ankesë, se në procedimin e kësaj

çështje kemi shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) dhe neni 182 par. 1 lidhur me nenin 199 të LPK-së. Se nuk ka bërë asnjë nga shkeljet e pretenduara sipas nenit 9.1 dhe 15.1 të Rregullores 2001/25. Pastaj, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas sugjerimeve të gjykatës së shkallës së dytë që në rastin e rigjyimit të vërtetohet disa nga faktet vendimtare dhe kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse se ka sërish mangësi, respektivisht shkelje dhe të meta në procedimin e çështjes nga gjykata e shkallës së parë. Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara. Sepse, aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe në arsyetimin e të njëjtit janë dhënë arsyet e nevojshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë”.

28. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit [AA. nr. 81/2017], të 5 tetorit 2017.
29. Më 25 janar 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjyimit [ARJ. UZVP nr. 69/2017], e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit [AA. nr. 81/2017], të 5 tetorit 2017 duke konstatuar se *“kjo Gjykatë vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, me rastin e refuzimit të padisë së paditësit, paraqitur kundër vendimit të BQK-së nr. 26-28/2013 dt. 30.04.2013, pasi që organi administrativ-e paditura BQK në një proces të rregullt ligjor ka bërë revokimin e licencës ndaj paditësit, në pajtim me nenet 9.1, 15.1 dhe 52 të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësuesve të Sigurimit si dhe Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës. [...] se pretendimet e parashtruesve të kërkesës janë të pabazuara ngase aktgjykimi i shkallës së dytë përmbanë arsye të mjaftueshme dhe se janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike, se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe në arsyetimin e të njëjtit janë dhënë arsyet e nevojshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. E drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit”.*

Pretendimet e parashtruesit

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar, Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe të drejtat e garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, si dhe parimin e proporcionalitetit me rastin e vënies se kufizimeve në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të punës dhe ushtrimit të profesionit.

Pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 6 të KEDNJ-së

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se dështimi i gjykatave në të gjitha instancat për të marrë në konsideratë dëshmitë dhe provat e propozuara nga

- parashtruesi i kërkesës është ne kundërshtim me: **(i)** te drejtën për një vendim te arsyetuar; dhe **(ii)** parimin e barazisë se armeve.
32. Përkitazi me **(i)** shkeljet e të drejtës për një vendim të arsyetuar parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar *“karakterizohet nga mungesa e arsytimit adekuat, respektivisht se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsytimit të mjaftueshme dhe adekuate përkitazi me refuzimin e kërkesës së Parashtruesit për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te Aktgjykimit te Gjykatës se Apelit te Kosovës [AA. nr. 81/2017], të 5 tetorit 2017 dhe Gjykatës Themelore te Prishtinës/Departamenti për Çështje Administrative [A. nr. 657/16], i 14 dhjetorit 2016 .”*
 33. Parashtruesi i kërkesës thekson se *“Gjykata Supreme ka dështuar qe te adresoj çështjet kyçe te ngritura nga parashtruesi ne te gjitha nivelet gjyqësore, ne nivelin themelore, te apelit dhe ne Gjykatën Supreme”*. Sipas parashtruesit *“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme te Kosovës vetëm se ka noterizuar vendimet e gjykatave me te ulëta dhe ka dështuar te ofroje arsytim te plote dhe adekuat lidhur me çështjet e ngritura, [...]”*
 34. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Supreme ka injoruar ne tërësi pretendimet lidhur me vërtetimin e çështjes kontestuese, pra nëse IIC Assitance kishte vazhduar te veproje si trajtues i dëmeve pa licence. Gjykata është mbështetur vetëm ne prezumime dhe raporte interne te BQK-se (te ashtuquajtura ekzaminime te fokusuara por nuk ka vërtetuar se cilat raste te dëmeve te identifikuara me numër protokolli janë trajtuar pa licence nga paditësi. Sipas parashtruesit te kërkesës “Fakti qe Gjykata Supreme ka vendosur çështjen vetëm duke u mbështetur ne raportet te brendshme dhe duke mos i vlerësuar shkresat e rasteve respektive te cilat ishin administruar si prova apo, ne rast nevojë te kërkohet edhe mendimi i ndonjë eksperti te pavarur nga lëmi i sigurimeve e bën vendimin te mangët ne pikëpamje te arsytimit adekuat.”*
 35. Sa i përket këtyre pretendimeve në lidhje me mungesën e arsytimit adekuat, parashtruesi i kërkesës thekson dhe citon vendimet e Gjykatës KI55/09, KI135/14, KI138/15 dhe KI97/16, si dhe vendimet e GJEDNJ-së, *Hiro Balani kundër Spanjës [1994], Ruiz Torija kundër Spanjës [1994], Helle kundër Finlandës [1997], Suominen kundër Finlandës [2003] dhe Gradinar kundër Moldavisë [2008]*.
 36. Përkitazi me **(ii)** shkeljen e parimit te barazisë se armeve parashtruesi i kërkesës konsideron se *“dështimi i gjykatave në të gjitha instancat e procedurave për t'i marrë në konsideratë dëshmitë dhe provat e propozuara nga parashtruesi i kërkesës, është në kundërshtim me parimin e barazisë së armeve dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si elemente thelbësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”*.
 37. Lidhur me këto pretendime për shkelje të parimit të barazisë së armeve në rastin e tij, parashtruesi i kërkesës thekson dhe citon Vendimin e Gjykatës KI31/17, si dhe vendimet e GJEDNJ-së, *Feldbrugge kundër Holandës [1986] dhe Dombo Beheer B.V. kundër Holandës [1993], Vand de Hurk kundër Holandës [1994]*.

38. Parashtruesi tutje thekson se *“kishte ngritur shqetësime për mospranimin e provave dhe pretendimet e ngritura lidhur me ligjshmërinë e revokimit të licencës në të gjitha instancat gjyqësore, por gjykatat nuk kanë marrë qëndrim lidhur me këto shqetësime dhe rrjedhimisht kanë shkelur “ekuilibrin e drejte” që është kusht për barazi të armeve ndërmjet palëve ndërgjyqëse në procedure administrative”*.
39. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konsideron se *“vet fakti se raporti mbi bazën e të cilit është revokuar licenca është përpiluar nga të punësuarit në një institucion publik (BQK) dhe që financohet nga buxheti i shtetit, nuk e arsyeton friken se këta zyrtarë mund të mos kenë vepruar në mënyre neutrale dhe të paanshme në dhënien e mendimeve të tyre profesionale lidhur me këtë rast.”*
40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se cenimi e barazisë së armëve në rastin e tij ka rezultuar me vendim të paarsyetuar dhe joadekuat nga Gjykata Supreme. Konkretisht parashtruesi konsideron se *“çfarëdo qëndrimi në aktgjykim të gjykatës që nuk shoqërohet me arsyetim adekuat të mbështetur në ligj le të nënkuptojë se gjykata (në këtë rast Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës) nuk i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme vërtetimit të fakteve kryesore të mbështetura në legjislacion.”*
41. Sipas parashtruesit *“në procedurat e rishikimit gjyqësore, një përsëritje stereotipe e arsyeve të gjykatave me të ulëta nuk konsiderohet i mjaftueshëm. Sidomos nëse gjykata bën vlerësimin e kufizimit të një ndërhyrje të autoritetit në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut (revokimi i licencës) është shume e nevojshme të adresohen të gjitha pretendimet relevante të palës referuese, dhe të shqyrtohen dhe vlerësohen shkalla e ndërhyrjes dhe shqiptimi i masave kufizuese në raport me të drejtë e palës dhe pretendimet e ngritura.”*
42. Parashtruesi i kërkesës thekson rëndësinë që Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj i jep vendimit të arsyetuar si dhe potencon se *“Çështja e arsyetimit të vendimit gjyqësor behet akoma më e rëndësishme nëse konsiderohet se Gjykata Supreme është organ gjyqësor i instancës së fundit, vendimet e se cilës themelojnë precedent –që munda të jënë me rëndësi të veçantë për gjykata të ulëta. Dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë arsyetim adekuat dhe të mjaftueshëm në bazë të ligjit cenon edhe parimin e sigurisë juridike për palët dhe pamundëson zhvillimin e një praktike konstante të interpretimit gjyqësor për çështje të ngjashme.”*
43. Parashtruesi i kërkesës pretendon mos zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese si dhe thirret në dhe citon prapë rastet KI55/09, KI135/14, KI97/16 dhe KI 138/15 duke konsideruar se konstatimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet e cekura e në veçanti konstatimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin KI138/15 *“...vlen gjithashtu për rastin konkret.”* Sipas parashtruesit *“.. rasti i cituar me lartë korrespondon dhe është identik me këtë edhe në një segment tjetër, ngase njëjtë i referohet çështjes së involvimit në kontekst për dy subjekte të ndryshme (këtu IIC Assistance dhe ICS Assistance)-kur gjykatat*

e instancës me të ulët kishin dështuar që drejtë të konstatonin këtë fakt, çfarë ishte reflektuar drejtpërdrejtë ne vendimet e atakuara gjyqësore.”

44. Parashtruesi gjithashtu thotë se “Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ne çështjen konkrete jo vetëm se nuk ka dhënë një vendim te arsyetuar ne mënyre adekuate por ka dështuare edhe ne përmbushjen e detyrimit kushtetues konform nenit 53 te Kushtetutës për te trajtuar çështjen gjyqësore ne kontekst te praktikes relevante te gjykatës evropiane, posaçërisht nuk ka bere një analize nëse ndërhyrjet administrative ne kufizimin e se drejtës se punës me rastin e revokimit te licencës janë proporcional dhe te domosdoshme.” Në lidhje me këtë, parashtruesi thirret prapë në rastet e GJENDJ-se *Boldea kundër Rumanise* [2007], *Hiro Balani kundër Spanjës* [1994] 45, para. 27, *Ruiz Torija kundër Spanjës* [1994]47, para. 29, *Helle kundër Finlandës* [1997]105, para. 55, *Suominen kundër Finlandës* [2003] 330, para.34, dhe *Gradinar kundër Moldavisë* [2008]279, para. 107.

(iii) Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës si dhe parimin e proporcionalitetit me rastin e vënies se kufizimeve në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të punës dhe ushtrimit të profesionit

45. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ. UZVP nr. 69/2017, të 25 janarit 2018 “*cenon edhe nenin 49 te Kushtetutës se Kosovës qe garanton te drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit si dhe parimin e proporcionalitetit me rastin e vënies se kufizimeve ne ushtrimin e se drejtës kushtetuese te punës dhe te ushtrimit te profesionit.*”
46. Parashtruesi i kërkesës thekson se “*dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë një arsyetim adekuat të vendimit gjyqësor në çështjen administrative që i referohet revokimit të paligjshëm të licencës të parashtruesit nga BQK përbën në mënyrë të hapur cenim edhe të së drejtës për punë dhe ushtrimin e lirë të profesionit [...]*”.
47. Duke iu referuar parimit të proporcionalitetit parashtruesi thekson se “*ne rastin konkret qartazi vërehet se ky parim kushtetues nuk është respektuar as nga BQK dhe as nga gjykatat respektive, përfshirë Gjykatën Supreme pasi IIC Assistance i është shqiptuar masa me e rende ne kuadrin e masave ndëshkuese (revokim licence) nga gjithsej 18 masa qe ka ne dispozicion BQK konform nenit 77 paragraf 1(r) duke i bere te pamundur ushtrimin e aktiviteteve dhe shërbimeve për te cilat është themeluar.*”
48. Sipas parashtruesit “*BQK dhe Gjykatat respektive nuk kane vepruar ne pajtim me nenin 49 dhe 55 te Kushtetutës se Republikës se Kosovës ...pasi kane dështuar te vlerësojnë nëse venja e një kufizimi te tille (revokimi i licencës si masa me e rende) është proporcionale për arritjen e qëllimit legjitim dhe e domosdoshme ne rastin konkret.*” Në lidhje me këtë Parashtruesi i kërkesës thekson dhe citon Vendimin e GJEDNJ-së, *Tre Traktorer Aktiebolag kundër Suedisë* [1984].

49. Parashtruesi tutje shton se “BQK dhe Gjykata respektive përfshire edhe Gjykatën Suprem nuk kane vepruar as ne pajtim me nenin 67 te Ligjit për BQK” pasi qe nuk janë marre parasysh kriteret e përcaktuara me ligj dhe as kriteri kushtetutes për ndërhyrje proporcionale ne venjen e kufizimeve administrative ne ushtrimin e te drejtave kushtetuese (liria e punës dhe e zgjedhjes se profesionit)”.
50. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm vendimin e kontestuar dhe të kthejë çështjen në rigjykim dhe rivendosje.
51. Në kërkesën e tij shtesë, parashtruesi i propozon Gjykatës “që në rast të anulimit të vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës, si vendimit të instancës së fundit gjyqësore të referohet se edhe vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, që janë marrë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga momenti i marrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.”

Dispozitat përkatëse ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 e 5 tetorit 2001

Mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit e të ndërmjetësuesve të sigurimit

[...]

Neni 9 Ndalesat

9.1 Askush nuk mund të angazhohet në biznesin e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit në Kosovës, nëse nuk është licencuar nga BPK-ja.

9. 2 Askush nuk mund të përdor fjalën “sigurim” apo ndonjë derivat të fjalës “sigurim” në lidhje me biznesin, emrin e firmës, prodhimin ose shërbimin pa lejen e lëshuar nga BPK-ja. Aq më tepër, askush nuk duhet të bëjë deklaram të rrejshëm për faktet materiale apo për një prezantim të rrejshëm, çorientues apo çkadoqoftë tjetër për të bërë një paraqitje të rrejshme a mashtruese ose të angazhohet me çfarëdo mjeti manipulues apo praktike në lidhje me lëshimin e policave të sigurimit.

[...]

Neni 15 Bazat për anulimin e licencës së kompanisë së sigurimit dhe ndërmjetësuesit të sigurimit

15. 1 BPK-ja mund t’ia anulojë licencën pa njoftimin paraprak kur vëren se:

[...]

(o) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit me qëllim ka ofruar informacion të rrejshëm ose çorientues për poseduesit e policave apo për BPK-në;

[...]

Neni 49 Revizioni i jashtëm financiar

1. Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të kenë gjendjet e tyre financiare të revizionuara në baza vjetore nga një firmë e licencuar e revizionit financiar.

[...]

KAPITULLI VIII QEVERISJA E BASHKUAR DHE KONTROLLAT E BRENDSHME

Neni 52 Parimet e qeverisjes

3 Drejtorët dhe nëpunësit e kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit si dhe nëpunësit përfaqësues të degës duhet të jenë persona “të përshtatshëm dhe adekuat” për të ushtruar rolin e tyre. Atyre nuk u lejohet që marrëdhëniet e tyre me aksionarët apo ndërmjetësuesit e kompanive të sigurimit, drejtorët, nëpunësit ose punonjësit tjerë të ndikojnë në çfarëdo mënyre në detyrat e tyre fiduciare ndaj poseduese të policave.

Pranueshmëria e kërkesës

52. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë të parashikuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
53. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 21

“[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

[...]”.

Neni 113

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

54. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

55. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar.

56. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

57. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

58. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit mund të përmbliidhen si në vijim:

(i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar,

(ii) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me parimin e barazisë së armeve, dhe

(iii) shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, si dhe parimit të proporcionalitetit me rastin e vënies së kufizimeve në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të punës dhe ushtrimit të profesionit.

(i) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar

59. Në lidhje me pretendimin për mungesën e arsytimit të vendimit, Gjykata rikujton se në bazë të praktikës gjyqësore kësaj Gjykate dhe të GJEDNJ –se e drejta për një gjykim të drejtë përfshin edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar. Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor është elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, (KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”,

Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; dhe KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019). Dhe të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ –se *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Ruisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007).

60. Në bazë të praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, GJEDNJ konsideron se, bazuar në parimin e administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe kolegjeve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen (Shih *Tatishvili kundër Ruisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; *Papon kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 54210/00, Aktgjykimi i 7 qershorit 2001).
61. Përveç kësaj, edhe pse GJEDNJ-ja ka konstatuar se autoritetet vendore gëzojnë një liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre të drejtësisë veprojnë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet "t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre" (Shih, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33). Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
62. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, funksioni themelor i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep palës mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, paragrafi 30, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001; shih, gjithashtu, *Tatishvili kundër Ruisë*, GJEDNJ, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).
63. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese e Kosovës theksoi se megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesi, ato megjithatë duhet t'i adresojnë pretendimet që janë thelbësore për rastet e tyre (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53).

64. Rrjedhimisht, Gjykata përsërit se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin edhe detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural, ashtu edhe në atë material (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).

Zbatimi i standardeve të lartpërmendura në rastin e parashtruesit të kërkesës

65. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar “*karakterizohet nga mungesa e arsytimit adekuat, respektivisht se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsytetime të mjaftueshme dhe adekuate përkitazi me refuzimin e kërkesës së Parashtruesit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [AA. nr. 81/2017, të 5 tetorit 2017] dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës/Departamenti për Çështje Administrative [A. nr. 657/16, i 14 dhjetorit 2016].*” Pretendimet tjera specifike të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor janë reflektuar në paragrafin 30-31 të këtij Aktvendimi.
66. Në këtë rast konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit [Aktgjykimi AA. nr. 75/2016] e pranoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [A. nr. 767/ 2013] dhe e ktheu çështjen në rivendosje. Gjykata e Apelit e obligoi Gjykatën Themelore “*që çështja kontestuese të shqyrtohet në tërësi dhe të vërtetohen në mënyrë të sigurt faktet relevante që janë me ndikim për zgjidhjen e kontestit, dhe në mënyrë të përcaktuar dhe të plotë ti theksoi faktet kontestuese dhe nga cilat shkaqe i merr si të provuara ose jo të provuara, duke theksuar qartë shkaqet për faktet vendimtare në mënyrë të kuptueshme të cilat duhet edhe arsyetuar.*”
67. Gjykata vëren se pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Apelit në rigjykim, Gjykata Themelore i ndërmori hapat në lidhje me administrimin e shkresave të propozuara nga parashtruesi. Në lidhje me këtë, Gjykata Themelore në Aktgjykimin A. nr. 657/16, arsyetoi se:

“lidhur me mos administrimin e shkresës me të cilin paditësi i ka njoftuar partnerët për pezullimin e licencës, mirëpo kjo gjykatë sikurse në gjykimin e parë kur e ka administruar këtë shkresë edhe tani vlerëson se kjo nuk paraqet bazë për të anuluar vendimin kontestues, pasi që provat tjera siç janë komunikimet elektronike të datës 28.01.2013, 29.01.2013, 07.02.2013 dhe 14.02.2013 në mes të përfaqësuesit të ICS Assistance dhe BKS-së, kanë vërtetuar të kundërtën.

[...]

Prandaj në këtë kontekst dhe në bazë të provave të lartcekura, është vërtetuar se padia është e pabazuar, ndërsa vendimi i të paditurës BQK Nr. 26-08/2013 i datës 30 prill 2013, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se më këtë aktvendim nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.”

68. Në lidhje me kërkesën e Gjykatës së Apelit që faktet relevante të vërtetohen në mënyrë të sigurt, Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj [A. nr. 657/16], pasi që në bazë të provave materiale (komunikimeve elektronike) vërtetoi se

parashtruesi është referuar si person i licencuar për trajtimin e dëmeve, arsyetoi se:

“Gjykata e ka pranuar si të saktë pretendimin e paditësit se për kompanitë që merren me këshilla juridike dhe regrese, nuk është e nevojshme licencimi nga ana e BQK-së, mirëpo nuk e ka pranuar si të saktë pretendimin se përfaqësuesit e paditësit në një kompani tjetër (ICS Assistance) nuk kanë ushtruar aktivitetin si trajtues i dëmeve dhe se nuk kanë përdorur titullin Trajtues i Licencuar i Dëmeve (Licenced Loss Adjuster).

Në këtë kuptim në cilësinë e provës materiale gjykata ka administruar komunikimet elektronike të datës 28.01.2013, 29.01.2013, 07.02.2013 dhe 14.02.2013 në mes të përfaqësuesit të ICS Assistance dhe BKS-së, me të cilat vërtetohet se i njëjti i është referuar si Trajtues i Licencuar i Dëmeve (Licenced Loss Adjuster).”

69. Nga ana tjetër, Gjykata Supreme në Aktgjykimin ARJ. UZVP. nr. 69/2017, në lidhje me gjetjet e Gjykatës Themelore, të cilat janë konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit, e arsyetoi vendimin e saj duke theksuar se:

“gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vërtetuar se në bazë të komunikimeve elektronike të datës 28.01.2013, 29.01.2013 dhe 14.02.2013, në mes të përfaqësuesit të ‘ICS Assistance’ dhe BKS, duke u thirrur në cilësinë e trajtuesit të dëmeve, e që është në kundërshtim me nenin 9.1 të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin i cili parashikon se askush nuk mund të angazhohet në biznesin e kompanisë së sigurimit, nëse nuk është i licencuar, apo të pretendoj të veprojnë si i licencuar, prandaj me të drejtë është konstatuar se veprimi i tillë përbën bazë për anulimin e licencës në pajtim me nenin 15.1 (par. o) të Rregullores nr. 2001/ 25.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, me rastin e refuzimit të padisë së paditësit, paraqitur kundër vendimit të BQK-së nr. 26-28/2013 dt. 30.04.2013, pasi që organi administrativ-e paditura BQK në një proces të rregullt ligjor ka bërë revokimin e licencës ndaj paditësit, në pajtim me nenet 9.1, 15.1 dhe 52 të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësuesve të Sigurimit si dhe Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës.

Si më sipër, Gjykata Supreme konstaton se pretendimet e paditësit janë të pabazuara ngase aktgjykimi i shkallës së dytë përmbanë arsye të mjaftueshme dhe se janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike, se vendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe në arsyetimin e të njëjtit janë dhënë arsyet e nevojshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. E drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.”

70. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se konkluzionet e gjykatave të rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, kanë rezultuar pas shqyrtimit të

detajuar të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës. Në këtë mënyrë, gjykatat e rregullta, duke marrë parasysh gjetjet nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ. UZVP. nr. 69/2017, i kanë konfirmuar faktet relevante dhe i kanë ofruar arsyet e tyre në lidhje me qëndrimet e tyre.

71. Prandaj, Gjkata konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ. UZVP. nr. 69/2017 është i qartë dhe i adreson në mënyrë të duhur të gjitha pretendimet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me vërtetimin e fakteve relevante lidhur me procesin e revokimit të licencës. Arsyetimi i dhënë nga Gjkata Supreme i plotëson standardet e një vendimi të arsyetuar që janë shqyrtuar më lartë dhe për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
72. Gjkata thekson qëndrimin e saj primar se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vërtetimit të fakteve apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28). Prandaj, Gjkata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri i 5 prillit 2012).

(ii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me parimin e barazisë së armeve

73. Gjkata rikujton se pretendimet për shkeljen e parimit të barazisë së armeve parashtruesi i kërkesës e ndërlihtë me “*dështimi i gjykatave në të gjitha instancat e procedurave për t’i marrë në konsideratë dëshmitë dhe provat e propozuara nga parashtruesi i kërkesës, është në kundërshtim me parimin e barazisë së armeve dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si elemente thelbësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*”.
74. Në rastin konkret, Gjkata konsideron se sipas nenit 6, paragrafi 3 pika d) të KEDNJ-së, palës nuk i jepet një e drejtë e pakufizuar për t’i dëgjuar dëshmitarët, ose për t’i paraqitur provat e tjera para Gjykatës, por, sipas rregullit, është detyrë e gjykatave të rregullta të vlerësojnë nëse është e nevojshme që të ftohen dëshmitarët e caktuar, si dhe nëse deklaratat e dëshmitarëve të propozuar apo paraqitja e provave të tjera të propozuara dhe veprimeve të tjera do të ishin relevante dhe të mjaftueshme për vendimmarrjen në rastin konkret (Shih, GJEDNJ, Vendimi i pjesshëm për pranueshmëri i 5 korrikut 2005, *Harutyunyan kundër Armenisë*, nr. 36549/03).
75. Në këtë drejtim, Gjkata vëren se Gjkata Themelore në Aktgjykimin e saj A. nr. 657/16, arsyetoi se vendimi i saj është marrë “*pas vërtetimit të të gjitha fakteve relevante dhe është bazuar në dispozitat ligjore në fuqi*“, dhe kjo, sipas mendimit të kësaj Gjykate, është ndjekur gjatë gjithë procedurës.

76. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsytetime të qarta dhe të hollësishme, si për çështjen e provave të cilat janë pranuar dhe administruar nga Gjykata Themelore, ashtu edhe për çështjen e provave të cilat janë refuzuar nga kjo gjykatë.
77. Gjykata konsideron se në vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta janë arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të argumentuar që askush nuk mund të angazhohet në biznesin e kompanisë së sigurimeve nëse nuk është i licencuar apo që të pretendojë të veprojë si i licencuar, prandaj me të drejtë është konkluduar se një veprim i tillë është bazë për anulimin e licencës në pajtim me nenin 15.1 (paragrafi l) të Rregullores nr. 2001/ 25. [...], organi administrativ - i padituri BQK, në procedurën e rregullt ligjore e revokoi licencën e paditësit në pajtim me nenet 9.1, 15.1 dhe 52 të Rregullores nr. 2001/25 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit e të ndërmjetësuesve të sigurimit, si dhe me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës.
78. Gjykata gjithashtu rikujton pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës se *“Fakti që Gjykata Supreme ka vendosur çështjen vetëm duke u mbështetur në raportet të brendshme dhe duke mos i vlerësuar shkresat e rasteve respektive të cilat ishin administruar si prova apo, në rast nevojë të kërkohet edhe mendimi i ndonjë eksperti të pavarur nga lëmi i sigurimeve e bën vendimin të mangët në pikëpamje të arsytimit adekuat.”*
79. Gjykata tashmë kishte vërejtur se gjykatat e rregullta zhvilluan një procedurë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse në të cilën janë administruar provat e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës dhe BQK-ja. Për më tepër, gjykatat e rregullta e adresuan kërkesën e parashtruesit lidhur me administrimin e shkresës me të cilën parashtruesi i kishte njoftuar partnerët për revokimin e licencës dhe arsyetuan për çfarë arsye nuk konsideruan se kjo paraqet bazë për anulimin e vendimit të kontestuar.
80. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë argumente të qarta dhe të sakta për të mbështetur të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e tyre. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund ta vlerësojë procedurën në gjykatat e rregullta si arbitrarë.
81. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij se gjatë procedurave gjyqësore nuk ka përfituar nga një procedurë kontradiktore; se nuk ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; që nuk ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtarë; që gjykatat nuk i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar nuk janë paraqitur në detaje nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata konsideron se procedura, shikuar në tërësinë e saj, ishte e drejtë (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, Vendimi i 4 tetorit 2000).

82. Gjykata, më tej, konsideron se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Vendimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
83. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).

(iii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës si dhe parimin e proporcionalitetit me rastin e vënies se kufizimeve ne ushtrimin e te drejtës kushtetuese te punës dhe ushtrimit te profesionit

84. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ. UZVP nr. 69/2017, të 25 janarit 2018 “*cenon edhe nenin 49 te Kushtetutës se Kosovës qe garanton te drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit si dhe parimin e proporcionalitetit me rastin e vënies se kufizimeve ne ushtrimin e se drejtës kushtetuese te punës dhe te ushtrimit te profesionit.*” Duke iu referuar parimit te proporcionalitetit parashtruesi thekson se “*ne rastin konkret qartazi vërehet se ky parim kushtetues nuk është respektuar as nga BQK dhe as nga gjykatat respektive, përfshirë Gjykatën Supreme pasi IIC Assistance i është shqiptuar masa me e rende ne kuadrin e masave ndëshkuese (revokim licence) nga gjithsej 18 masa qe ka ne dispozicion BQK konform nenit 77 paragraf 1(r) duke i bere te pamundur ushtrimin e aktiviteteve dhe shërbimeve për te cilat është themeluar.*”
85. Gjykata rithekson se neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës, thotë:
- “1. E drejta e punës garantohet.*
- 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”*
86. Ne këtë aspekt, Gjykata vëren se ne kuptimin e kësaj te drejte konkrete, neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetues, përkufizon një standard që përcakton garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime të dhunshme. Këto të drejta janë të rregulluara me ligjet e aplikueshme (shih, ndër të tjera, Aktvendimin për papranueshmëri ne rastin KI46/15, me parashtrues *Zejna Qosaj*, të publikuar më 20 tetor 2015, paragrafi 26, Aktvendimi për papranueshmëri KI70/17, me parashtrues *Rrahim Ramadani*, të publikuar më 8 maj 2018, paragrafi 49-50, Aktvendim për papranueshmëri në rastin KI 64/18 me parashtrues *Hasan Maxhuni*, i publikuar më 30 nëntor 2018, paragrafët 74-76).

87. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës në punë duhet kuptuar në dritën e interpretimit të mësipërm. Mbrojtja e të drejtave të punës, në mënyre specifike është e rregulluar me dispozitat e ligjeve të aplikueshëm, interpretimi dhe zbatim i të cilave është detyrë e gjykatave të rregullta.
88. Prandaj, dhe në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata gjen se e drejta e punës është e garantuar për sa kohë individi vepron në përputhje me kushtet ligjore nga licenca e punës, si dhe me ligjin e aplikueshëm i cili e rregullon këtë fushë.
89. Gjykata vëren se në rastin konkret Bordi Ekzekutiv i BQK-së nxori Vendimin nr. 49-30/2012, fillimisht e pezulloi licencën e parashtruesit të kërkesës (IIC Assistance) duke pretenduar shkeljet “e nenin 49.1 të Rregullores Nr. 2001/25 mbi Licencimin,” më pas më 23 prill 2013, BQK zbatoi një ekzaminim të fokusuar të zyrës së parashtruesit të kërkesës, me ç’rast ekzaminerët e Departamentit për Licencim dhe Rregullim të BQK-së i rekomanduan Bordit Ekzekutiv të BQK-së që parashtruesit të kërkesës, për shkak të shkeljeve të konstatuara, t’i revokohet licenca për trajtimin e dëmeve (*shih paragrafët 15-19 të këtij raporti/aktgjykimi*).
90. Në rastin konkret, në procedurën para gjykatave të rregullta në disa raste është vërtetuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar në përputhje me ligjin e aplikueshëm i cili e rregullon këtë fushë. Rrjedhimisht, nuk ka prova se parashtruesit të kërkesës i është mohuar e drejta për punë të ligjshme dhe ushtrim të profesionit sipas kuptimit të nenit 49 të Kushtetutës. Në rastin konkret Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin në pajtim me ligjet dhe dispozitat e aplikueshme ligjore.
91. Sipas praktikës së kësaj gjykate dhe GJEDNJ-se detyra e kësaj gjykate nuk është të shqyrtoj se perse parashtruesit të kërkesës nuk i është vendosur një masë tjetër siç pretendon parashtruesi “nga gjithsej 18 masa që ka në dispozicion BQK konform nenit 77 paragraf 1(r) duke i bere te pamundur ushtrimin e aktiviteteve dhe shërbimeve për të cilat është themeluar”. Gjykata vëren se këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, më saktësisht me mënyrën se si BQK-ja ka përzgjedhur masën ndëshkimore të shqiptuar, rrjedhimisht Gjykata thekson se është një rregull i përgjithshëm, sipas të cilit roli i gjykatave të rregullta është interpretimi dhe zbatimi i dispozitave të ligjit, në rastin konkret, masa ndëshkimore që ka përzgjedhur BQK-ja ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla këto pretendime nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, respektivisht, Gjykata në parim nuk mund t’i shqyrtojë (shih: rastin nr. KIO6/17, parashtrues: *L.G. dhe pesë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; dhe rastin KI122/16, parashtrues: *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
92. Në këtë drejtim, pretendimet të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 49, Gjykata i gjen të pabazuara, për arsye se nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që do të

arsyetonte konkludimin se janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës.

93. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
94. Sa i përket vendimeve të Gjykatës dhe vendimeve të GJEDNJ-së të cituara nga parashtruesi në kërkesën e tij, Gjykata thekson se rrethanat e rasteve të referuara nga parashtruesi i kërkesës nuk përkojnë me rrethanat e rastit konkret.

Përfundim

95. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se argumentet e ngritura në kërkesë nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës, dhe se ai nuk i ka mbështetur pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë, përkatësisht me nenet 31 dhe 49 të Kushtetutës.
96. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7, dhe 21 paragrafi 4 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 prill 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arteta Rama-Hajrizi